

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Gjykatësin e Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar i Nasim Haradinajt

Data: 14 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

**KËRKESË URGJENTE PËR SHTYRJEN E PARAQITJES SË PARË PËR NË
DATËN 18 DHJETOR 2020**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris QC
Hju Bouden

Mbrojtësi i Nasim Haradinajt
Bas Martens

KSC-BC-2020-07

1. Më 14 dhjetor, në orën 11:50, Mbrojtja u vu në dijeni të Aktakuzës së konfirmuar (rregulla 85 dhe rregullat vijuese).
2. Pasditen e të njëjtës date, më 14 dhjetor, në orën 15:56, Mbrojtja e z. Nasim Haradinaj u informua se seanca e paraqitjes së parë do të mbahej të nesërmen, përkatësisht të martën, më 15 dhjetor, në orën 15:00.
3. Në seancën e paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të vendosë për dispozitat dhe të drejtat e parashikuara në nenin 39(5) të Ligjit dhe rregullën 92(2).
4. Koha që ka në dispozicion Mbrojtja për t'u përgatitur për seancën e paraqitjes së parë është shumë e shkurtër, duke marrë parasysh se:
 - janë dhënë vetëm 23 orë për t'u përgatitur për seancë;
 - Aktakuza e konfirmuar doli më 14 dhjetor, në mesditë, dhe është dokument ligjor kompleks prej 16 faqesh;
 - Z. Haradinaj mbahet në paraburgim në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Mbrojtja arriti të organizonte një takim urgjent në *Zoom* në orën 18:00, por nuk kishte përkthyes të disponueshëm. Për rrjedhojë, Mbrojtësi nuk pati kurrfarë mundësie për të diskutuar Aktakuzën me klientin e vet, z. Haradinaj, për t'u përgatitur për seancën e paraqitjes së parë. Për këtë arsye, z. Haradinaj nuk mund të bëjë një vlerësim për pozitën e tij në seancën e paraqitjes së parë.

Disponueshmëria e palëve për seancë u kërkua më 4 dhjetor. Mbrojtësi i z. Haradinaj u përgjigj menjëherë: *'Gjatë javës 14-18 dhjetor, jam i disponueshëm: të hënën, më datë 14 | të martën, më datë 15, pasdite (pas orës 13:), dhe të mërkurën. Mundësisht personalisht, por edhe përmes videolidhjes, nëse është e nevojshme.'* Domethënë,

KSC-BC-2020-07

dihej se Mbrojtësi nuk ishte i disponueshëm për seancë paraditen e datës 15 dhjetor (duke dhënë mësim nga ora 10:00 deri në orën 12:00), që e shkurtonte edhe më tej kohën për përgatitje për seancën të martën pasdite.

Në fakt, Mbrojtësi nuk ka pasur kohë për t'u përgatitur për seancë ose për t'u këshilluar me klientin e vet në asnjë mënyrë të përshtatshme.

5. Duhet mbajtur parasysh po ashtu se Aktakuza u dorëzua nga ZPS-ja më 30 tetor 2020 dhe ishte nën shqyrtimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për një muaj e gjysmë. Mbrojtja nuk ka pasur kurrfarë ndikimi mbi kohën e shqyrtimit të Aktakuzës. Po kështu, Mbrojtja duhet të marrë parasysh edhe faktin se, nga data 18 dhjetor, DHKS-ja do të jetë e mbyllur për pushimin e fundit të vitit, duke i lënë Mbrojtjes efektivisht vetëm disa ditë për të shqyrtuar dhe diskutuar Aktakuzën.
6. Dihet gjithashtu se seanca e paraqitjes së parë të z. Gucati është caktuar për të premten, më 18 dhjetor 2020.
7. Për arsyet e lartpërmendura, Mbrojtësi i z. Nasim Haradinaj i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ta shtyjë seancën e paraqitjes së parë për të premten, 18 dhjetor 2020.
8. Mbrojtësi i z. Haradinaj dhe z. Haradinaj dëshirojnë të jenë të pranishëm fizikisht në seancë në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

[Numri i fjalëve (në origjinal) : 446]

/nënshkrimi/
Bas Martens

Mbrojtësi i specializuar i Nasim Haradinajt

14 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë.